

EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë/Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA), Tiranë
edmond.malaj@asa.edu.al

**MARRËVESHJE DHE ÇËSHTJE TË TJERA NDËRMJET
RAGUZËS DHE FISNIKËVE ARBËRORË****Abstrakt:**

Ky punim jep të dhëna rreth marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Republikës së Raguzës dhe disa familjeve të rëndësishme fisnike shqiptare në Mesjetë. Punimi synon të prezantojë disa nga diplomat dhe marrëveshjet më të rëndësishme që këto familje kanë bërë me shtetin e Raguzës. Marrëveshjet janë kryesisht të natyrës ekonomike dhe kanë të bëjnë kryesisht me veprimtarinë tregtare të tregtarëve raguzanë në trevat shqiptare. Familjet, marrëdhëniet e të cilave trajtohen në këtë punim janë Kastriotët, Arianitët, Topiajt, Dukagjinët, Balshët, princat e Arbrit etj., pra fisnikëria më e rëndësishme shqiptare gjatë Mesjetës. Punimi bazohet kryesisht në dokumente arkivore të Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut.

Fjalë kyçe:

Familje fisnike shqiptare, Republika e Raguzës, tregtarë raguzanë, Arianitët, Topiajt, Dukagjinët, Balshajt, Matrangajt, Principata e Arbrit, Dhimitri i Arbrit.

Dy fjalë hyrëse

Në lidhje me marrëdhëniet diplomatike dhe ekonomike ndërmjet Arbërisë dhe Raguzës ka të dhëna të shumta nëpër dokumentet raguzane. Në fillim, sidomos në shek. XIII këto misione diplomatike, ndërmjet Raguzës e sunduesve arbërorë kishin një karakter afatshkurtër dhe kalimtar, por më vonë ato u bënë më të qëndrueshme dhe filluan të

marrin një karakter me përfaqësi të përhershme.¹ Marrëdhëniet diplomatike të raguzanëve me qytetet arbërore erdhën duke u zhvilluar, saqë më vonë ato gjetën sanksionime dhe përcaktime ligjore në Raguzë dhe këto i hasim edhe në “*Statutet e qytetit të Raguzës*” (*Statuta Civitatis Ragusi*), të fiksuara me shkrim qysh në vitin 1272.² Aty gjejmë të dhëna mbi shërbimet diplomatike të raguzanëve nëpër qytetet arbërore dhe jepen edhe informacione si për shembull për pagesën në para, si dhe për përfitime të tjera.

Në këto statute gjejmë të dhëna rreth marrëdhënieve me portet e mëdha arbërore si Durrësi³ dhe Vlora,⁴ apo me qytetet e Shkodrës, Ulqinit e Tivarit⁵ dhe zonat e Arbrit,⁶ të cilat nëpër këto statute, kishin nene për të përcaktuar kontaktet afariste dhe marrëdhëniet me Raguzën.⁷ Si shembull mund të përmendim se, sipas këtyre statuteve, për sa u përket anijeve që vinin nga Durrësi dhe qëndronin në port, duhej të paguanin si taksë arborazhi (tarifë për të huajt që mbërrijnë nga deti) një hyperper.⁸

Në artikullin e mëposhtëm po japim disa të dhëna interesante për sa u përket këtyre marrëdhënieve diplomatike me karakter ekonomik, duke u bazuar kryesisht në marrëveshjet dhe lidhjet ndërmjet Republikës së Raguzës dhe dyerve fisnike më të rëndësishme gjatë Mesjetës. Në rrjedhën e këtij artikulli do të sjellim edhe disa diploma të bëra nga

¹ Jahja Drançolli, “Diplomatët Shqiptarë në shërbim të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e shkencave historike, 19-1989 (Prishtinë: 1990), 38.

² *Liber Statutorum civitatis Ragusii. Compositus anno 1272. Cum Legibus Aetate posteriore insertis atque cum summariis, adnotationibus et scholiis a veteribus juris consultis ragusinis additis, nun primum in lucem protulerunt, praefatione et apparatu critico instruxerunt, indices adjecerunt v. Bogošić et C. Jireček. Sumtibus Academiae Scientiarum et artium Slavorum Medidionalium, Volumen IX (Zagrabiae: Ex Officina Societatis Typographicae MCMIV, 1904).* (Më tej cituar si: *Liber Statutorum*, Liber ..., cap. ..., f.).

³ *Liber Statutorum*, I, cap. XIII, 11; II, cap. XXIV, 46.

⁴ *Liber Statutorum*, II, cap. XXIV, 46.

⁵ *Po aty.*

⁶ *Po aty.*

⁷ Shih edhe: Bogumil Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria në shekujt XIII, XIV dhe XV”, në *Gjurmime Albanologjike* nr. 1-2 (Prishtinë: 1970), 29.

⁸ *Liber Statutorum*, I, cop.XIII. De arboratico foresteriorum venientium per mare: [4] *Naves omnes vel barce que venunt a partibus Larte usque Dyrrachium in Ragusium et faciunt portum, dant pro arboratico de nave ypperperum unum pro quocue arbore.*”, 11.

bujarët arbër, sidomos në favor të tregtarëve raguzanë dhe do të bazohemi në një numër të konsiderueshëm dokumentesh që pasqyrojnë këto marrëdhënie.

Marrëveshjet tregtare dhe çështje të tjera ndërmjet Raguzës dhe sunduesve arbërorë

Ndër marrëdhëniet e vjetra me Raguzën mund të përmendim këtu marrëveshjen e Dhimitrit (*Demetrio Arbanensi principi Demetrium judicem Albanorum*)⁹, të birit të Progonit që ishte sundues në Krujë,¹⁰ pas pushtimit të Kostandinopojës të ndodhur në vitin 1204, e cila hyn në serinë e marrëveshjeve miqësore që Dubrovniku ka bërë me fqinjët e vet që nga gjysma e dytë e shek. XII,¹¹ si p. sh.: marrëveshjet e Dubrovnikut në vitin 1148 me Molfetin, më 1169 me Pizën, 1181 me Kotorin, 1186 me Nemanjën e Mirosllavin, 1188 me Ravenën, 1192 me Bizantin, 1199 me qytetin Fano e Ankonën, 1201 me qytetin Monopoli, 1201 me Barin, 1203 me Tremolen, në vitet 1214-1217 me zhupanin Stefan.¹²

Në lidhje me Dhimitrin mund të themi se, ai “ka qenë i martuar me Komninën, të bijën e Shtjefnit të parë të kunorzuar, bijë e mbretëreshës Eudokija. Më 28 shkurt 1208, Papa Inocenti i shkruan një letër “burrit fisnik Dhimitrit të Arbrit, pra princit Dhimitër, gjykatës të Arbërve” (*nobili viri Demetrio Arbanensi principi Demetrium judicem Albanorum*), ku e kërcënon me ndëshkimin e kishës. Në vitin 1216 Dhimitri nuk rron më, se njëfarë Grigor Kamona donte që të martohej me Komninën të bijën e zhupanit të madh Shtjefnit, të vejën e Dhimitrit, të birit të Progonit.¹³ Dhimitri në këtë letër quhet “Arkont i Arbërve”

⁹ Alexander V. Solovjev, “Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios, Megas Archon von Albanien”, në *Byzantinische Zeitschrift* 34, 2 (1934), 304-310; shih përkthimin e këtij dokumenti tek: *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut me sunduesin e Shqipërisë në fillimin e shek. XIII-të”, 2.

¹⁰ Dhimitër Progoni kishte marrëdhënie të ngushta edhe me familjet fisnike serbe të kohës. Ai ishte dhëndri i zhupanit të madh Stefan Përvençani. B. Hrabak, “Eksportimi i drithërave nga Shqipëria”, 28.

¹¹ *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 3.

¹² A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 307; shih edhe: *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 3.

¹³ A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 305; shih edhe: *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 2.

(αρχών του 'Αρβάνου), dokumenti është pa datë, por, ngaqë ka një stil të ngjashëm me një diplomë latine të ban Kulinit në vitin 1189, mund të supozohet që është shkruar ose nga fundi i shek. XII, ose nga fillimi i shek. XIII.¹⁴ Për rëndësinë që ka, dokumentin në fjalë po e sjellim të përkthyer plotësisht, si më poshtë:

“† Unë Dhimitri, Panhypersevast dhe Arkon i madh me Hirin e Perëndisë, betohem mbi katër Ungjijtë e Shenjtë të Zotit Tonë, pa mashtrim dhe pa mendime të këqia, se do të mbajë paqe të palëkundur (të padiskutueshme) përgjithmonë, gjatë gjithë jetës sime, me qytetarët e Raguzës, pa asnjë kushtë, me qëllim që ata, pra raguzanët vetë të mund të lëvizin të mbrojtur dhe të sigurtë nëpër të gjithë territorin tim, pa ndonjë pagesë/ me të gjitha të drejtat, qoftë nëpër tokë, qoftë nëpër detë dhe të sigurtë. Dhe ashtu sikurse po betohem unë me vendosmëri, po ashtu u jap urdhër të gjithë njerëzve të mi që të betohen dhe të mbajnë këtë premtim për të gjitha ditët e tyre. Unë Andrea Stapani betohem (u betova), Unë Jonima betohem. Unë Marken Aleksi betohem! Unë Dimetri betohem! Unë Kozmai betohem! Unë Sermeli betohem! Unë Lazarus betohem! Unë Gjoni betohem! Unë Nikolla betohem! Unë Pelti betohem! Unë Leu betohem! Unë V...ni betohem! Unë Sundia Andrea betohem!”¹⁵

¹⁴ A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 308; shih edhe: Aleksander Solovjev, “Marrëveshje e Raguzës me princa shqyphtarë kah fillimi i XIII shekull”, në *Hylli i Dritës* (XIV) (1938), 12, 702.

¹⁵ Dokumenti origjinal: A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 304-305: “† Ego Demetrius Dei gratia panyperseuastos et magnus archon juro super quattuor sancta Dei euangelia sine | fraude et malo ingenio firmam pacem habere et manutenere senper uite mee dum uixero ciuitati Ragusij et omnibus hominibus Raguseis, ut ipsi Ragusei salui et securiambularent per totam terram meam sine (n)ullo datio| in omnibus iustitijs suis tam per terram quam per mare liberi et securi. et sicut ego hoc iuro et firmo ita precipio omnibus | hominibus meis ut hoc iurent et firmiter teneant omnibus diebus uite eorum | Ego Andreas stapanus iurau. Ego Jon(e)ma iurau. Ego Marken iurau. Ego Alexi iurau. | Ego Paullus iurau. Ego Dimetri iu . . . E . . Cosmas iurau. Ego Serneli iurau. Ego Lazarus | iurau. Ego lohaner (sie) iurau. Ego Nicola . . . ui. Ego P(e)ltus iurarau (sie). Ego V . . ni iurau. E . . Leu iurau. Ego sundia Andrea iur. . . |” Shih përkthimin dhe interpretimin tek: AIH, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 2-3, 9-10; dhe te A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 701-707.

Dhimitri nëpërmjet marrëveshjes u premtoi raguzanëve tregti të lirë, pa paguar ndonjë gjë, në të *gjitha proceset e tyre*, qoftë atyre që kalojnë nëpërmjet trojeve të tij, qoftë atyre që lëvizin dhe jetojnë atje, dhe përveç kësaj edhe lëvizje të lirë dhe siguri, qoftë nëpër tokë, qoftë nëpër det.¹⁶ Për sa i përket frazës së mësipërme “në të gjitha proceset e tyre” (*in omnibus iustitiis suis*), aty bëhet fjalë se çështjet e tyre gjyqësore do të trajtohen me drejtësi.¹⁷

Shenja e Kryqit (†) që ndodhet në dorëshkrimin origjinal është një invokacion simbolik dhe në tekst zëvendëson invokacionin verbal “*In nomine Patris et Filii et Spiritus Sancti!*”.¹⁸ Ky dokument u gjet nga Aleksander Solovjev në arkivin e bashkisë së Dubrovnikut, u botua për herë të parë në revistën “Byzantinische Zeitschrift, nr. 34, 2” në vitin (1934)¹⁹ dhe, i përkthyer në shqip nga Aleksander Preluca, u botua edhe në revistën “Hylli i Dritës”.²⁰ Dokumenti është i rëndësishëm, sepse është përpiluar nga krerë shqiptarë, të cilët bënë një marrëveshje me një shtet të zhvilluar e të përparuar siç ishte në atë kohë Republika e Raguzës.²¹ Nga pikëpamja juridike dhe historike dokumenti ka rëndësi të veçantë, sepse na dëshmon se princat shqiptarë ishin gjatë kësaj kohe të pavarur nga Bizanti dhe se është një marrëveshje që i përket fushës së diplomacisë ndërkombëtare, qoftë nga stili, qoftë nga forma.²² Me anë të nënshkrimit princat shqiptarë e paraqesin veten të veçuar nga bizantinët, latinët dhe sllavët.²³ Identifikimi dhe roli i këtyre personave që shënohen në listën e të betuarve është i pamundur, por mendohet se mund të kenë qenë ose “burra nderi” ose kryetarë fisesh. Bien në sy emri i parë *Andrea Stapani* dhe ai i fundit *Sundia Andrea*, të cilët, me sa duket, janë të shoqëruar me tituj. *Stapanus* mbase do të thotë “*kryetar i një vendi*”, kurse “*Sundia*” është fjalë sllave dhe do të thotë “*gjyqtar*”.²⁴ E ngjashme me këtë marrëveshje është edhe ajo (povela) e bërë midis Mihailit të Epirit me dubrovnikasit në vitin 1206, pikat e së cilës janë:

¹⁶ A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 304.

¹⁷ Po aty, 305; shih edhe: *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 6.

¹⁸ A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 305; shih edhe: A. Solovjev, “Marrëveshtje e Raguzës”, 704.

¹⁹ A. V. Solovjev, “Eine Urkunde”, 304-310.

²⁰ A. Solovjev, “Marrëveshtje e Raguzës”, 701-707.

²¹ *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 2-3, 9-10.

²² A. Solovjev, “Marrëveshtje e Raguzës”, 701.

²³ *AIH*, A-II-18, “Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut”, 6.

²⁴ *Po aty*, 4.

1. Në qoftë se ndonjë dubrovnikas vdes në Epir, pasuria e tij u jepet trashëguesve të tij e jo arkës së mbretit;

2. Dubrovnikasit janë të liruar nga taksat, ata paguajnë vetëm një taksë të shitjes së mallit 3 për qind;

3. Në rast se ndonjë anije e Dubrovnikut copëtohet në bregun e Epirit, çdo teshë e shpëtuar do t'u kthehet dubrovnikasve;

4. Në qoftë se ndonjë dubrovnikas i mbetet borxh ndonjë epiroti, kreditori nuk do të mundet të burgosë tjetër njeri veç marrësit.²⁵

Përveç këtyre kemi edhe marrëveshje të ndryshme të bëra edhe ndërmjet Stefan Dushanit e tregtarëve të ndryshëm raguzanë.²⁶ Marrëveshje të tjera kishte edhe me familjet fisnike sunduese, si për shembull me Balshajt, sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIV por edhe më pas.²⁷ Po ashtu, marrëdhënie të shumta ekonomike-tregtare kishte edhe me familjet e tjera të rëndësishme fisnike si me Topiajt, Arianitët, Dukagjinët etj.²⁸ Siç do ta shohim edhe në vazhdim.

Edhe Dukagjinët kanë bërë marrëveshje me Raguzën. Këto marrëveshje fillojnë që në gjysmën e dytë të shek. XIV. Si shembull i parë mund të përmendet marrëveshja e Lekë Dukagjinit I, e cila është bërë në dhjetor të vitit 1387.²⁹ Këtu nuk bëhet fjalë për Lekë Dukagjinin që ka jetuar në kohën e Skënderbeut, por për një figurë më të hershme që ishte i vëllai i Palë Dukagjinit dhe, me sa duket, i ati i Tanush dhe Progon Dukagjinit, zotërve të Lezhës, të cilët ia dorëzuan këtë qytet venedikasve në vitin 1393.³⁰ Në marrëveshjen në fjalë, Dukagjinët u garantojnë tregtarëve raguzanë liri lëvizjeje dhe garanci në lidhje me jetën e mallrat

²⁵ A. V. Solovjev, "Eine Urkunde", 304-305; shih edhe: *AIH*, A-II-18, "Marrëveshja e panjoftun e Dubrovnikut", 8.

²⁶ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovig de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay, Volumen II (Annos 1344-1406 continens) (Vindobonae MXMXVIII: Typis Adophi Holzhausen, 1918), nr. 33. (Më tej cituar si: *AAlb*, II, nr.).

²⁷ Muhamet Mala, *Shqiptarët dhe Evropa Qendrore gjatë shekujve XII-XVII*. Me vështrim të posaçëm në marrëdhëniet kroate-hungareze dhe austriake (Zagreb: Unioni i Bashkësive Shqiptare në Republikën e Kroacisë, 2010), 95.

²⁸ *Po aty*, 97-106.

²⁹ Gjon Shllaku, "Dokumenta historije. Lekë Dukagjini I. u shkruhen Raguzinve", *Hylli i Dritës* (XVIII) (1940), 12, 83.

³⁰ Šime Ljubić, *Listine o odnašajih između južnogo Slavenstva i Mletačke republike*, Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD, Knjiga IV, Od godine 1358 do 1403 (Zagreb: U knjižarnica Fr. Župana na prodaju, 1874), 317.

e tyre, dhe se nuk ishin të rrezikuar as nga turqit ngaqë kishin bërë paqe me ta.³¹ Ndërsa në lidhje me pagesën e doganës, ata u premtojnë raguzanëve që do të marrin vetëm aq sa kishin paguar më parë edhe te sundimtarët e tjerë.³²

Matrangajt ishin po ashtu një familje e rëndësishme fisnike, e cila përmendet nëpër dokumentet historike qysh prej vitit 1297, e që kishin zotërimet e tyre në krahinën e Karavastasë,³³ por edhe në afërsi të Shkumbinit, në Vrego. Pronat e tyre shtriheshin ndërmjet grykëderdhjeve të lumenjve Shkumbin dhe Seman.³⁴ Nëpër dokumentet raguzane Matrangajt përmenden që në fillim të gjysmës së dytë të shek. XIV. Ndër ta përmendet në mënyrë të veçantë Vlash Matranga (*Vlasius* apo *Blasius Matarangos*), i cili ishte sebastokrator dhe zot i territoreve në krahinën e Elbasanit, që kishte nën zotërimin e tij edhe grykëderdhjen e lumit Shkumbin (*sebastocrator, dominus ad ostium fluminis Vregi*),³⁵ por që kryeqendra e tij administrative duhet të ketë qenë Pirgu, nën Vlash Matrangën kjo familje arriti edhe kulmin e lulëzimit të saj.³⁶

Tani për sa u përket marrëdhënieve të V. Matrangës me Raguzën mund të përmendim fillimisht një dokument të datës 22 tetor të vitit 1358, që është një vendim i Këshillit të Vogël, ku flitet për një anije të armatosur dhe letra që duhej t'u jepeshin Vlash Matrangës dhe Stepe de Giorgio-s e Niko de Mlaskanjas. Këta të dy, Niko dhe Stepe, porositeshin pastaj me anë të atyre letrave se duhej të ktheheshin në Raguzë, po me atë barkë, brenda gjashtë ditësh.³⁷ Me sa duket, qytetarët raguzanë Stepe de Giorgio dhe Niko de Mlaskanja ishin agjentë tregtarë të Raguzës, të cilët merreshin me gjetjen dhe blerjen e mallrave dhe transportimin e tyre në Raguzë, sepse emrat e tyre na shfaqen edhe nëpër dokumente të tjera.³⁸

³¹ Gj. Shllaku, "Dokumenta historije", 83. (Origjinali ruhet në Arkivin e Dubrovnikut: HR-DADU- Div. Canc. 1386-II, 38).

³² Po aty.

³³ Gj. Varfi, *Heraldika shqiptare* (Tiranë: Dituria, 2000), 57.

³⁴ Petrika Thëngjilli, "Matrangët", në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Botim i ri, vëll. II (H-M) (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008), 1658.

³⁵ *AAlb*, II, 281.

³⁶ Gj. Varfi, *Heraldika shqiptare ...*, 57.

³⁷ *AAlb*, II, nr. 132; shih edhe: *Monumenta Ragusina. Liber Reformationum*, Tomus II, A. 1347-1352, 1356-1360. Additamentum a. 1301-1305, 1318, 1325-1336 (Zagabriae: Sumptibus Scientiarum et Artium, 1882), 246. (Më tej cituar si: *Monumenta Ragusina* 2).

³⁸ *Po aty*, 253, ref. nr. 132; *AAlb*, II, nr. 132.

Për sa u përket marrëdhënieve me Raguzën, studiuesja gjermane I. Mahnken e vendos fillimin e tyre në vitin 1360,³⁹ pasi ishin bërë përpjekje të ndryshme për bisedime me të. Për shembull, edhe në vitin 1359 ishte nisur nga Ragusa një i dërguar me dhurata te Vlash Matranga, me porosi të Këshillit të Madh.⁴⁰

Marrëveshjet tregtare të raguzanëve me Vlash Matrangën të përfunduara rreth vitit 1360, duhet të jenë bërë kryesisht për drithëra,⁴¹ megjithatë krahas drithërave raguzanët ngarkonin edhe produkte ushqimore të tjera, si për shembull mish derri.⁴² Këto bisedime në vitin 1360 vërtetohen nga disa dokumente që i përkasin sidomos periudhës mars-prill. Kështu, më 17 mars 1360, Këshilli i Rogatëve me dakordësinë e të gjithë anëtarëve vendosi që të dërgojë një përfaqësues të tyre te Vlash Matranga, të pajisur madje edhe me një dhuratë prej 55 dukatesh. Ky përfaqësues ishte caktuar të shkonte jo vetëm te Matranga në Vrego⁴³, por edhe në Devoll (*Yevalum*) dhe në Pulia. Ai duhej të nisej për të siguruar drithë dhe për të kryer punët e tjera me të cilat ishte ngarkuar, dhe në rast se refuzonte të nisej për atje do të ndëshkohej me një gjobë prej 50 perperësh.⁴⁴

Misioni nëpër këto vende do të zgjaste dy muaj dhe atij i ishte vënë në dispozicion një anije dhe 35 perperë. I zgjedhuri për këtë mision ishte fisniku raguzan Dobro de Mençe.⁴⁵ Këto të dhëna që përmendëm më sipër u përkasin dokumenteve të lëshuara nga shteti i Raguzës në mars të vitit 1360. Megjithatë, Ragusa dërgoi ambasadorë te Vlash Matranga edhe një muaj më vonë, pra në prill të vitit 1360 dhe i përzgjedhur si

³⁹ Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung", *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*, Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26.VIII. – 1.IX.1966 (München: Trofenik, 1966), 352.

⁴⁰ *Monumenta Ragusina* 2, 269; *AAlb*, II, nr. 137.

⁴¹ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern", 352.

⁴² *Monumenta Ragusina* 2, 253; *AAlb*, II, nr. 133.

⁴³ *Monumenta Ragusina* 2, 290; *AAlb*, II, nr. 145.

⁴⁴ *AAlb*, II, nr. 145; shih edhe: *Monumenta Ragusina. Libri Reformationum*, Tomus III (A. 1359-1364), Collegit et digessit Josephus Gelcich (Zagabriae: Sumptibus Academiae Scientiarum et Artium. Ex officina Societatis Typographicae, 1895) 27. (Më tej cituar si: *Monumenta Ragusina* 3).

⁴⁵ *Monumenta Ragusina* 3, 27; *AAlb*, II, nr. 145.

ambasador përmendet kësaj radhe fisniku Georgius de Bodaça, të cilit i ishte caktuar një barkë, një ndihmës dhe një rrogë prej 25 perperësh.⁴⁶

Vlash Matranga kishte bërë bisedime ndërmjetësuese për Raguzën edhe me qytetin e Durrësit.⁴⁷ Porse nëpër dokumente raguzane, paraqitet edhe një ndërmjetësim që vetë Raguza bën ndërmjet V. Matrangës dhe Durrësit, të cilët në atë kohë (1360) kishin pasur mosmarrëveshje. Për këtë arsye, për të bërë bisedime për paqen dhe për mirëkuptimin midis Vlashit dhe durrsakëve (*at tractandum pacem et concordiam inter Duracenos et Blasium Mataragno*), Këshilli i Vogël i Raguzës dërgon te Vlashi dhe në Durrës ambasadorin Nicolaus de Grede, të cilit i paguhet një rrogë prej 50 perperësh, qiraja e barkës dhe kuajt, dhe në rast se do të refuzonte këtë detyrë, atij i duhej të paguante një gjobë prej 100 perperësh.⁴⁸

Problemet ndërmjet Durrësit dhe Matrangajve, të cilat po mundohej t'i qetësonte Raguza, lidheshin me faktin se pikërisht gjatë kësaj periudhe zotërimet e Matrangajve ishin sulmuar nga Karl Topia,⁴⁹ i cili në atë kohë ishte zot i Durrësit. Përveç këtyre marrëveshjeve, me Vlash Matrangën ishin bërë edhe marrëveshje për ndërprerjen e raprezaljeve nga ana e tij ndaj tregtarëve raguzanë.⁵⁰ Marrëdhëniet e Raguzës me Matrangajt vazhdojnë edhe pas vdekjes së Vlashit, me të birin e tij Gjon Matrangën (*Johannes Mataranga*). Vlashi që vvarë nga Balsha II, pasi ky shtiu në zotërimin e tij Myzeqenë.⁵¹

Emri i Gjonit shfaqet në disa dokumente të majit të vitit 1386. Nga një dokument i datës 11 maj 1386, mësojmë se Republika e Raguzës e kishte bërë Gjon Matrangën, qytetar të saj, sipas mënyrës me të cilën bënin qytetarë dhe fisnikët e tjerë të Sllavonisë.⁵² Edhe në një dokument tjetër të datës 19 maj 1386, përmendet një dhuratë prej 50 dukatesh që duhej t'i jepej Gjon Matrangës.⁵³ Në lidhje me marrëdhëniet e Matrangajve me Raguzën nuk po zgjatemi më dhe po vazhdojmë me disa të dhëna për marrëdhëniet e raguzanëve me Topiajt.

⁴⁶ *Monumenta Ragusina* 3, 30; *AAIb*, II, nr. 145.

⁴⁷ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern", 352.

⁴⁸ *AAIb*, II, nr. 147; *Monumenta Ragusina* 3, 31-32; *Monumenta Ragusina* 2, 90.

⁴⁹ P. Thëngjilli, "Matrangët", 1658.

⁵⁰ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern", 352.

⁵¹ P. Thëngjilli, "Matrangët", 1659.

⁵² *AAIb*, II, nr. 398.

⁵³ *Po aty*.

Edhe Topiajt kishin marrëdhënie me Raguzën. Në vitin 1364 ishin bërë edhe marrëveshje për ndërprerjen e raprezaljeve nga ana e Karl Topisë ndaj tregtarëve raguzanë.⁵⁴ Duket se këto raprezalje kishin ndodhur shpeshherë, sepse ato përsëriten edhe dhjetë vjet më vonë dhe në lidhje me to është pikërisht një dokument i datës 20 maj 1374, ku përmendet frati Pelegrin i cili në shërbim të komunës së Raguzës ishte caktuar që të shkonte te Karl Topia. Ai duhej të zbriste në çdo port të mundur që do ta shihte më të përshtatshëm, por jo në qytetin e Durrësit. Ai duhej t'i lutej zotërisë në fjalë (K. Topisë) për gjërat që i ishin grabitur Palë Klapoviqit, për kthimin e të cilave komuna e Raguzës i kishte dërguar shumë letra. Gjithashtu duhej t'i lutej atij për të garantuar edhe një kalim të sigurt të tregtarëve raguzanë nëpër krahinat e lumenjve Vrego (Shkumbin) dhe Devoll,⁵⁵ sepse kishte ndodhur disa herë që anijet raguzane ishin grabitur edhe plaçkitur nga njerëzit e Karl Topisë, siç e vërtetojnë edhe shumë dokumente të viteve 1370-1379.⁵⁶ Më tej në lidhje me Topiajt janë të njohura relacionet e Karl Topisë me Raguzën gjatë viteve 1385-1386. Në dokumente paraqiten përgjigje dhe vendime nga Këshilli i Madh (*Consilium Maiorum*), Këshilli i Vogël (*Consilium Minorum*), Këshilli i Rogatëve (*Consilium Rogatorum*) dhe nga kancelarë e rektorë të ndryshëm.

Për shembull, në një dokument të datës 20 dhjetor të vitit 1385 bëhet fjalë për caktimin e një personi në vend të një avokati⁵⁷ dhe lajmëtari, i cili me një anije të tipit brigantinë, me dhjetë ushtarë këmbësorë dhe 60 rremëtarë brenda, duhej të shkonte në vendin e Karl Topisë dhe në Vlorë me qëllim që të siguronte drithë.⁵⁸ Një vit më vonë

⁵⁴ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern", 352.

⁵⁵ *Monumenta Ragusina. Libri Reformationum*, Tomus IV (A. 1364-1396) (Zagabriae: Sumptibus Academiae Scientiarum et Artium. Ex officina Societatis Typographicae, 1896), 141; AAlb, II, nr. 319; shih edhe: Giuseppe Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*, Studi storici dokumentati del Prof. Giuseppe Gelcich (Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), 1899), 102.

⁵⁶ AAlb, II, nr. 292.

⁵⁷ *Syndacus* = Kjo fjalë ka shumë kuptime, por këtu bëhet fjalë sigurisht për një person i cili mbron interesat e një korporate apo të një komune ose bashkie, siç ishte në këtë rast Ragusa. Shih më gjerë: *Pierer's Universal-Lexikon der Vergangenheit und der Gegenwart oder Neues encyclopädisches Wörterbuch der Wissenschaften, Künste und Gewerbe*, Vierte, und umgearbeitete und stark vermehrte Auflage. Band 17. (Altenburg: H. A. Pierer, 1863), 145.

⁵⁸ AAlb, II, 95.

kemi disa të dhëna të tjera në lidhje me marrëdhëniet midis Karl Topisë dhe Raguzës.

Në një shënim të datës 18 prill 1386 të Këshillit të Rogatëve bëhet fjalë për kërkim ndjesë me fjalë miqësore para të dërguarit të Karl Topisë, në lidhje me një ankimim a padi,⁵⁹ për të cilën dokumenti në fjalë nuk na jep më tepër sqarime. Por, me sa duket, atij i kthejnë përgjigje të vazhdueshme, një herë më 20 gusht 1385, duke caktuar në fillim një lajmëtar e pastaj duke dërguar me anë të tij edhe letra me përgjigje⁶⁰ dhe më vonë edhe më 22 gusht 1386, dhe për përgjigjet që do t'i ktheheshin Karl Topisë, i jepej autoritet i plotë rektorit të Këshillit të Vogël bashkë me Këshillin e Rogatëve.⁶¹

Më sipër, pra, bëhet fjalë për një sërë relacionesh të ndryshme midis Karl Topisë dhe Raguzës në periudhën kohore 1385-1386 (*De Ragusanum com Carolo Thopia relationibus, 1385-1386*), për të cilat në dokumente nuk jepen të dhëna të tjera specifike, por me siguri këto relacione kishin lidhje me çështje tregtie.

Për sa u përket marrëdhënieve ndërmjet Balshajve dhe Raguzës ka tashmë disa hulumtime të botuara, por këtu po përmend veçanërisht monografinë e Jozef Gelçiq-it (Giuseppe Gelcich) me titull “Zeta dhe Dinastia e Balshajve”⁶² dhe artikullin e Gjon Berishës me titull “Marrëdhëniet e Gjergjit II Strazimir Balshës me Republikën e Raguzës”⁶³. Në këtë artikull po jap vetëm disa të dhëna qendrore duke u bazuar kryesisht në diplomatat që Balshajt lëshuan për tregtarët raguzanë.

Me vdekjen e Stefan Dushanit filloi dhe dobësimi i pushtetit qendror serb, i cili solli edhe kryengritjet serbe që çuan në rënien e Perandorisë së Slavonisë. Gjatë kësaj kohe Balshajt, të cilët më 1361 futën nën zotërimin e tyre edhe Budvën, kishin lidhur aleancë me Raguzën, e cila kishte filluar një konflikt të hapur kundër Perandorit serb

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, nr. 403.

⁶² Giuseppe Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*, Studi storici dokumentati del Prof. Giuseppe Gelcich (Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), 1899) / Në shqip: Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, Përktheu nga origjinali Laura Leka (Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009).

⁶³ Gjon Berisha, “Marrëdhëniet e Gjergjit II Strazimir Balshës e Republikën e Raguzës”, në *Studime historike*, nr. 3-4 (2019), 37-57.

Urosh V (1355-1371).⁶⁴ Kjo aleancë u bë sipas formulës së njohur latine “*nemicus nemici mei, amicus meus est*” (armiku i armikut tim, është miku im), sepse operacionet luftarake për serbët, kundër raguzanëve i ndërmori vasali i tyre, zoti i Bosnjës Vojslav Vojniq, i cili erdhi deri poshtë në Zetë, duke dobësuar kështu edhe synimet e Balshajve për nënshtrimin e plotë të Zetës, dhe ishte po ashtu një kërcënim për pushtimin e Budvës.⁶⁵

Aleanca u forcua edhe më shumë sa Balshajt, të cilët tashmë e kishin vizituar Raguzën,⁶⁶ gjatë kësaj kohe u bënë edhe “qytetarë nderi të Raguzës”, e cila u dërgoi atyre përfaqësuesin e saj Klime Dërzhiq. Dërzhiq kishte si detyrë të pranonte nga ata “betimin e qytetarisë raguzane” dhe të lidhte marrëveshje për miqësi e mbrojtje ushtarake në kohë paqeje dhe lufte.⁶⁷ Fuqia e tyre në krahinën e Zetës dhe në Arbërinë Veriore vazhdoi të rritet edhe më tej, kështu që në janar të vitit 1367 Balshajt bëhen zotër të Lezhës dhe të doganës së Dejës,⁶⁸ dhe më 20 qershor 1368 ata janë të dokumentuar edhe si zotër të Ulqinit.⁶⁹ Pikërisht gjatë kësaj periudhe Balshajt lëshuan në favor të raguzanëve edhe një diplomë, e cila i përket datës 17 janar 1368 dhe ishte përpiluar në Lezhë (te vendi i quajtur *Kalimi i Gjerë* “*traiectum largum*”). Në këtë diplomë Gjergj Strazimiri dhe vëllai i tij Balsha II, përcaktuan që raguzanët ishin të çliruar nga taksat, të cilat duhej të paguheshin në doganën e Dejës.⁷⁰

Gjergj Balsha (†1378) i zgjeroi edhe më tej territoret e Balshajve midis Kotorrit dhe Durrësit, përmes pushtimit të Prizrenit në vitin 1372 pas vdekjes së Mbretit Vukashin.⁷¹ Më vonë, në vitin 1373 zhupani Nikola Altmanoviq, me qëllim që të fshihej nga armiqtë e tij të shumtë, i dorëzoi Gjergjit krahinat e Drashevicës (në *Castelnuovo*), Kanalën dhe Trebinjën.⁷² Kështu, Gjergj Balsha u bë fqinj me Raguzën dhe merrte nga

⁶⁴ Qerim Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)* (Tetovë: ARS-ZZ, 2012), 50.

⁶⁵ *Po aty*, 49, 50.

⁶⁶ Bariša Krekić, *Dubrovnik, Italy and the Balkans in the Late Middle Ages* (London: Variorum Reprints, 1980), 388.

⁶⁷ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut...*, 50.

⁶⁸ *Po aty*, 57.

⁶⁹ *AAIb*, II, nr. 244.

⁷⁰ *Po aty*, nr. 235.

⁷¹ Kostandin Jireček, *Historia e Serbëve* - Pjesa e dytë, Shqipëroi Elda Gjana-Boriçi (Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2010), 137.

⁷² *Po aty*.

raguzanët haraçin e Shën Dhimitrit, që dikur u takonte mbretërve dhe carëve serbë.⁷³

Vlen të përmendet këtu se, gjatë kësaj kohe Balshajt i lëshuan Raguzës një diplomë, e cila u lejonte tregtarëve raguzanë qarkullimin e lirë nëpër territoret e tyre, dhe ndër të tjera këta tregtarë ishin gjithashtu të liruar përkohësisht edhe nga pagesa e taksës në doganën e re të Dejës.⁷⁴ Por ky liberalizim në lidhje me taksat ishte vetëm përkohësisht sepse, më vonë me fuqizimin e pushtetit të tyre në vitin 1372 Gjergj I Balsha ua rivendosi taksën tregtarëve raguzanë në doganën e Dejës dhe në atë të Kriva Rekës pranë Novobërdës, duke i detyruar të paguanin dy dinarë për thes.⁷⁵ Gjergj Balsha Plaku ka pasur pra marrëdhënie me Raguzën, dhe raguzanët e njohën si personalitet politik dhe e patën mik të qytetit të tyre, dhe në një dokument raguzan vihen në dukje zakonet e tij shqiptare.⁷⁶

Edhe Balsha II vazhdoi të kishte marrëdhënie me Raguzën, dhe më 23 prill 1385 në Tuz (në afërsi të Plloçës) ai u lëshoi atyre një diplomë, në të cilën ai u konfirmonte privilegjet që u kishte dhënë edhe paraardhësi i tij, Gjergji I Balsha. Diploma në fjalë përcaktonte gjithashtu që tregtarët të cilët kalonin nga Deja, nuk detyroheshin të paguanin gjë.⁷⁷

Disa muaj më vonë, më 18 shtator 1385 Balsha II ra në Betejën e Savrës (Lushnjë), në luftë kundër turqve⁷⁸ dhe ushtria e tij u shpartallua. Osmanët ishin thirrur aty nga rivali i tij Karl Topia, të cilit Balsha i kishte marrë Durrësin. Prandaj Balsha në dokumentin e sipërpërmendur e quan veten “dukë i Durrësit” (*dei gratia Dyrrhachii dux*). Konfirmimin e këtyre të drejtave e bëri më vonë edhe Gjergj II Strazimiri. Në diplomën e

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Q. Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut...*, 57, 65; Kr. edhe: *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë (shek. VIII-XV)*, vëll. II, përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo K. Frashëri, Petraq Pepo (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1962), nr. 112.

⁷⁵ *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë ...*, vëll. II, nr. 112.

⁷⁶ Lulëzim Lajçi, *Shkodra në shekullin XV* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997), 43-44, ref. 124.

⁷⁷ “1385, 24. aprilis. “In Tuzi prope Pločam.” Balsa (II.) „dei gratia Dyrrhachii dux et cetera (...) privilegia a fratre suo Georgio (I.) Ragusinis concessa3) confirmat; “mercatores, qui in Serbiam proficiscuntur, Dagni nihil solvant” (...). Cuius rei rogatarius praefectus aerario Philippus.” AAlb, II, nr. 388.

⁷⁸ Pranvera Bogdani, “Balshajt”, në *Fjalor Enciklopedik Shqiptar* (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1985), 64.

lëshuar nga ai në Shkodër, më datë 27 janar 1386, thuhet se ai: “*Gjergj (II) Strazimiri, zot i krahinave të Zetës dhe të atyre bregdetare u konfirmon raguzanëve privilegjet e dhëna nga sunduesi i Serbisë dhe nga Strazimiri e Gjergj Balsha; që të mos u kërkohet taksë as në Dejë e as në ndonjë vend tjetër të territoreve të mia, ashtu siç ka qenë dikur në kohën e perandorit Stefan. Nëpër tokat dhe nëpër lumenjtë e mi, ata mund të blejnë dhe mund të nxjerrin drithë lirshëm duke paguar vetëm dy denarë për thes. Të ngarkuar me këtë çështje guvernatorët e thesarit Filip dhe Nikollë Vojvoda dhe Mladen Iljiq. E shkruajti logoteti Butko.*”⁷⁹

Ndër marrëdhëniet e tjera mund të përmendim edhe ardhjen e një mjeku nga Ragusa, magjistrin mjek Albertino (*magister Albertinus physicus*), të cilit, pas një refuzimi të parë, i jepet leje nga Këshilli i Madh i Raguzës të shkojë në Arbëri për një periudhë kohore prej 20 ditësh me një pagë prej dy dukatesh në ditë.⁸⁰ Mjekun që shkoi te Balshajt në janar të vitit 1389 ua kishte kërkuar raguzanëve edhe vetë Gjergj II Strazimir Balsha, nëpërmjet një letre të dërguar që në vitin 1387.⁸¹

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe (1387), kemi edhe një dokument tjetër ku flitet në lidhje me një përgjigje që i kthehet letrës së Gjergjit nga Këshilli i Madh, ku bëhet fjalë për një shumë parash prej 30 hyperperësh, të cilat do t’i dërgoheshin atij me anë të një ambasadori të caktuar nga Këshilli i Vogël, i përbërë nga Licas de Bona, Clemend de Goçe dhe Jacobus de Gondula.⁸² Përgjigjja dhe vendimet mbajnë datat 16 mars dhe 20 mars të vitit 1387.

Në vitin 1407 përmenden edhe dy qytetarë raguzanë, që kishin vepruar si ambasadorë të Raguzës te Balshajt. Këta ishin Nikola de Goze, dhe një fisnik tjetër raguzan i quajtur Mikel de Resti. Këta kishin qenë ambasadorë te Balshajt, por kur ishin kthyer nga ambasada e Balshës,

⁷⁹ “1386, 27. ianuarii. „Sub Scutaro. Georgius (II.) Sracimiri, Zetae et Maritimae regionis dominus privilegia a dominis serbicus et a Sracimir, Georgio Balsa Raguseis concessa confirmat; „nec Dagni nec ubicumque terrarum mearum portorium exigatur, sed sit, sicut fuit tempore imperatoris Stephani”.4) „In terris meis et luminibus emant libere extrahantque frumentum duos denarios pro sacco (...) solventes.” Cuius rei rogatarius (...) praefectus aerario (...) Philippus et Nicolaus vojvoda et Mladen Iljic. Scripsit logotheta Butko.” AAlb, II, nr. 391.

⁸⁰ Po aty, nr. 405.

⁸¹ Po aty, ref. 1.

⁸² Po aty, nr. 405.

ishin burgosur. Më 16 gusht 1407, u vendos që ata të lirohen e të falen.⁸³ Nuk po merremi më tej me Balshajt, pasi duam t'u lëmë një hapësirë edhe Kastriotëve dhe Arianitëve e lidhjeve të tyre që kishin me Raguzën.

Për sa u përket marrëdhënieve të Kastriotëve me Raguzën, ne i kemi cekur ato tashmë në një artikull,⁸⁴ dhe këtu po përmendim shkurt vetëm disa fakte që janë të rëndësishme. Marrëdhëniet me Kastriotët janë të dokumentuara qysh në kohën e Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut, i cili u bë qytetar i Raguzës në vitin 1413. Dokumenti në lidhje me këtë çështje thotë, se më “21 të marsit të (1413) në Senat bëhet propozimi i parë për zotin Gjon Kastrioti për ta bërë atë qytetar dhe fqinj me të gjitha privilegjet dhe imunitetet me të cilat pranohen qytetarët e tjerë që bëhen të tillë për nder”⁸⁵. Disa vite më vonë, më 25 shkurt të vitit 1420, Gjon Kastrioti së bashku me djemtë e tij lëshon një letër përcjellëse për kalim të lirshëm (*salvakondukt*) për tregtarët e Raguzës që donin të kalonin nëpër vendin e tij, në Shufada e më tej e që kishin si destinacion Prizrenin.⁸⁶ Në letër jepen edhe përcaktime në lidhje me doganat. Ja seç thotë marrëveshja në fjalë:

“Un zotni Gjini ap besen n’êmen t’êm e të bijve të mij çë do tregtari të republikës së qytetit të Raguzës qi ká me dashtë të vîjë në token t’eme qi thirret Shufada a se qi ká me dashtë të bâjë tregtí në token t’eme a por ka me dashtë të kalojë neper Shtetin t’êm në token e Gjergjit a se të zotni Despotit, kështu po u ap besen qi porsa të vîjn në token tëme Shufadaj po bâni e u ndodhi

⁸³ *AIH*, A-III-563, “Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV (1406-1410)”, vëll. II, përgatitën për botim Injac Zamputi, Përparime Huta (të pabotuara), nr. 156.

⁸⁴ Edmond Malaj, “Kastriotët dhe Raguza”, në *Studime historike*, nr. 3-4 (2020), 29-60.

⁸⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë së shek. XV (1411-1416)*, vëll. II, Transkriptuan dhe përkthyen Injac Zamputi, Përparime Huta, Redaktoi dhe përgatiti për botim Edmond Malaj (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2018), nr. 223.

⁸⁶ Ludwig von Tallóczy, Konstantin Jireček, “Zwei Urkunden aus Nordalbanien”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte (München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916), 125; shih tekstin e plotë edhe tek: *Archiv für slavische Philologie*. Bd. 21 (1899), 95; Jovan Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Abanija u XV Beku*. (Istoriska Grača) (Beograd: Srpska Kraljevska Akademia, 1942), nr. 2.

gjâ e keqe deri në Prezrend, un zotni Gjini e bijt e mij kemi me u a shperblye. Me ket ligjë caktohen të dhettat e të hîmit mbasi kemi rá në godi me mikun t'êm e vllán t'uej Pjetrin; në mbarë token t'ême s'keni me la veç një të dhetë, d.m.th per një kvintal cohë kan me u 1a dy dukat e per një kvintal grûn një perper. Në token e Turkut, Radunje, ká me u 1a një gjysë dukati per cohë e per gûn gjashtë dinarë. Per percjellsa në token t'ême deri në Shufadaja ká me u la per mâ teper një perper per dýll, inbul (?) e per tjera sende; në Radunje por kan me i u la Turkut gjashtë dinarë. Në tanë këtë (kje pranë) kryetari i financave Pjetri (venecjan). Shkrue vjetin 1420 me 25 fruer.”⁸⁷

Ndër marrëdhëniet tregtare mund të përfshijmë këtu edhe marrjen me qira të anijeve raguzane nga ana e Gjon Kastriotit dhe njerëzve të tij për të transportuar mallra dhe njerëz. Një rast i tillë përmendet më 31 maj 1426, kur njerëzit e Gjon Kastriotit marrin një anije me qëllim që të shkojnë në Ankonë.⁸⁸ Vendimet që ishin marrë më parë për doganat, shihen edhe një herë në vitin 1430, por nga bisedimet që qenë bërë në lidhje me këtë çështje në janar të këtij viti, me sa duket, mbeten në fuqi vendimet doganore të mëparshme.⁸⁹ Si ambasador i Gjon Kastriotit përmendet Nikollë Suma, i cili nderohet edhe nga Ragufa duke iu dhuruar 50 hyperperë në pëlhurë dhe 150 në argjend për zotërinë e tij Gjon Kastriotin.⁹⁰

Më 25 maj të vitit 1433 Gjoni kishte dërguar një ambasador në Venedik, i cili kërkonte që: a) pëlhurat e blera për shtëpinë e tij të përjashtoheshin nga taksat doganore; b) që të arratisurit t'i ktheheshin; c) që oficerët venedikas të Lezhës të mos i bënin “*novitates ingabella*” e të mos i sillnin vështirësi për doganën e tij të Shufadasë “*Dohana del Sufedal*”; dhe çfarë është më e rëndësishme për sa u përket marrëdhënieve me Raguzën, d) që tregtarët e Raguzës që kalonin nëpër Lezhë e që kishin si qëllim ardhjen në zotërimet e tij, as të mos

⁸⁷ Át Gjon Shllaku OFM, *Shqypnari – Frati – Shqypnija*, Përgatitën për botim Át Vitor Demaj, OFM, prof. dr. Aljula Jubani, Át Mirash Marinaj, OFM (Shkodër: Botime Françeskane, 2018), 106-107.

⁸⁸ Gjon Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut. Dokumente* (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2018) nr. X.

⁸⁹ *Po aty*, nr. XX.

⁹⁰ *Po aty*, nr. XXI.

ndaloheshin e as të mos pengoheshin. Senati aprovoi pikat a) dhe c); dhe akordoi kthimin e robërve, të shërbëtorëve dhe të pasurive dhe u zotua se do të lejonte edhe kalimin e raguzanëve nëpër Lezhë për një periudhë kohore dyvjeçare.⁹¹

Pas vdekjes së Gjon Kastriotit (më 1437 ose në vitin 1438),⁹² Senati i Raguzës e konfirmoi qytetarinë dhe u jep edhe djemve të Gjon Kastriotit nënshtetësinë e Republikës, duke përjashtuar këtu Gjergj Kastriotin, i cili në atë kohë duhet të ketë qenë në shërbim të Perandorisë Osmane. Vendimi në lidhje për këtë u mor më 10 korrik 1439.⁹³ Për sa u përket marrëdhënieve ndërmjet Skënderbeut dhe Raguzës, sigurisht dokumentacioni është më i gjerë. Këtu po japim vetëm një përmbledhje të shkurtër dhe do të cekim vetëm disa momente të rëndësishme të këtyre marrëdhënieve. Fillimisht po përmendim një dokument të datës 27 maj 1447, i cili bën fjalë për një ndihmë në materiale ushtarake që i jepet Skënderbeut. Kjo ndihmë konsistonte në 500 libra barut bombardash që i dërgohen atij me aprovimin e pothuajse të gjithë Këshillit të Rogatëve.⁹⁴

Mbi një vit më vonë, më 20 tetor 1448, kemi një kërkesë të Skënderbeut për një hua, por Ragusa i përgjigjet negativisht Skënderbeut në lidhje me këtë hua, të cilën ai e kishte kërkuar nëpërmjet Andreas, ipeshkvit të Arbrit.⁹⁵ Megjithatë, raguzanët kësaj here i dhurojnë Skënderbeut 200 dukate.⁹⁶ Po atë vit, më 14 nëntor 1448, Ragusa vendosi t'i dërgojë Skënderbeut dy kuaj “të racës asturias” si dhuratë.⁹⁷ Pas betejës së Oranikut më 1448 dhe pas pushtimit të Sfetigradit në vitin 1449, turqit të prirë nga Sulltan Murati II me të birin, sulmojnë sërish

⁹¹ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 6.

⁹² Jireček shprehet se, për sa i përket vdekjes së Gjon Kastriotit, nëpër literaturë dhe dokumente të ndryshme nuk është e qartë se kur ka ndodhur. “Sipas Ljubić 9, 214 dhe Jorga 3, 33, Gjon Kastrioti ishte gjallë në mars të vitit 1438. Porse dy shënime serbe japin si datë vdekjeje të enjten, më 2 ose më 9 maj 1437. Stojanović, *Zapisi* 1 nr. 270-271; shih për këtë: Constantin Jireček, *Geschichte der Serben*, Zweiter Band/ Erste Hälfte (1371-1537.) (Gotha: Friedrich Andreas Parthes A.-G, 1918), 183, ref. 4.

⁹³ L. Tallóczy, K. Jireček, “Zwei Urkunden aus Nordalbanien”, 142.

⁹⁴ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 14.

⁹⁵ *Po aty*, nr. 24; Dhimitër Shuteriqi, *Moti i Madh*. Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479 (Tiranë: Dituria, 2006), 150.

⁹⁶ Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, 150.

⁹⁷ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 25; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, 151.

trojet arbërore në vitin 1450 dhe patën rrethuar Krujën.⁹⁸ Mbi këtë rrethim janë të mirinformuar edhe raguzanët, siç na tregon edhe një letër e tyre e datës 13 gusht 1450, e cila i ishte nisur Janosh Huniadit për ta informuar.⁹⁹ Pikërisht për këtë problem Skënderbeu bëri një udhëtim në Raguzë në vitin 1450.¹⁰⁰

Në Raguzë, ai kërkoi ndihma me qëllim që të mbronte Krujën nga turqit.¹⁰¹ Ndihamat që iu dhanë, u morën nga shumat që ishin mbledhur nga klerikët si lëmosha për Papën. Një dokument i datës 14 dhjetor 1450, flet për një vendimmarrje nga Këshilli i Rogatëve që t'i jepeshin Skënderbeut 500 dukate.¹⁰² Këtu nuk është e qartë nëse kjo shumë ishte ajo që duhej të nxirrej nga lëmoshat, apo ndonjë shumë tjetër. Skënderbeu me këtë ndihmë u kthye në Arbëri dhe arriti jo vetëm të mbajë Krujën, por të fusë në dorë një pjesë të mirë të zotërimit të vet.¹⁰³ Si rrjedhim, për shkak të këtyre shumave të dhëna Skënderbeut, Raguzë i kërkonte tashmë ndihmë Papës, sepse Regjimenti i Shenjtë që ndodhej në Raguzë i cili shërbente për mbrojtjen e fesë kishte shpenzime dhe kështu Republika i kërkonte Papës që “një e katërta e mbledhur” nga lëmoshat t'i kalonte në dispozicion këtij regjimenti. Për këto çështje Raguzë vendosi të dërgonte në Romë të dërguarin e saj arbërorin Gjon Gazulli, i cili për këtë punë duhej të pajisej edhe me një bulë nga Raguzë e të fliste në Romë për pesë ditë për punët e Skënderbeut, dhe të nxirrte lejen me qëllim që të merrte ndihmat Raguzë.¹⁰⁴

Gjon Gazulli në këtë kohë ishte vikar i argjipeshkvit të Raguzës dhe rektor i kishës së Shën Pjetrit në qytet (*Johanni Gazulo, rectori*

⁹⁸ Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Di Giammaria Biemmi, Prete Bresciano, Seconda Edizione (Brescia: Giammaria Rizzardi, 1756), 233; shih edhe: Julius Ernest Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie* (Wien: Frick, 1894), 55.

⁹⁹ HR-DADU - Lett. et Comm. di Lev. 1448-88, f. 38, në József Gelcich, Lajos Thallóczy, *Ragusa és Magyarország összeköttetéseinek oklevéltára* (Budapest: Kiadja A. M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága, 1887), nr. 284 (474).

¹⁰⁰ B. Krekić, *Dubrovnik, Italy ...*, 388.

¹⁰¹ HR-DADU- Lett. e comm. di Lev. 1448-1488, fol. 64-68; Letër e Raguzës dërguar Papë Nikollës V më 27. 2. 1451, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 36; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, 165.

¹⁰² J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 34.

¹⁰³ *Po aty*, nr. 36.

¹⁰⁴ *Po aty*; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, 165.

ecclesie Sancti Petri Maioris Ragusine)¹⁰⁵ dhe disa muaj më vonë, më 13 prill 1451 së bashku me argjipeshkvin e Raguzës Jakobin dhe me ipeshkvin e Kotorrit, Bonino de Tolentis, ai ngarkohet nga Papa Nikolla V për t'i dhënë Skënderbeut një pjesë të shumës së fituar nga indulgjencat e vitit jubilar 1450.¹⁰⁶ Por kjo mbledhje fondesh duket se nuk qe fort e lehtë, sepse në atë kohë kishte edhe një problem tjetër, murtajën e cila duket se kishte shkaktuar edhe zbrazjen e qytetit.¹⁰⁷ Fondet ndihmëse u bënë gati një vit më vonë, më 18 mars 1452. Ipeshkvi Andrea Suma, si prokurator i plotfuqishëm i Skënderbeut, iu dorëzuan në Raguzë 4893 hyperperë,¹⁰⁸ të cilat ishin grumbulluar me nismën e Selisë Apostolike në krye të së cilës në atë kohë ishte Papa Nikolla V.¹⁰⁹

Gjatë periudhës prill-qershor 1459 ka disa dokumente që flasin për tërheqje shumash të ndryshme nga Skënderbeu, nga depozitat që ai kishte lënë në Raguzë, të cilat përmenden gjithsej me shumën 2 400 dukate ari.¹¹⁰ Dokumenti i parë në lidhje me tërheqjen e këtyre shumave është i datës 2 prill 1459, dhe Skënderbeu nëpërmjet të dërguarve të tij kërkon nga komuna e Raguzës 500 dukatet e para.¹¹¹ Më 13 qershor të vitit 1459, Skënderbeu merr nga komuna e Raguzës një shumë të dytë prej 900 dukatesh,¹¹² dhe po më datë 13 qershor 1459 tërhiqet shuma prej 1 000 dukatesh ari, të cilat ishin sasia e fundit e depozituar atje.¹¹³ Nëpër këto dokumente nuk jepen të dhëna rreth shkakut pse u morën këto të holla. Por, gjatë kësaj periudhe ai e kaloi kohën duke bërë meremetime e duke i

¹⁰⁵ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 40.

¹⁰⁶ *Po aty*; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, 168.

¹⁰⁷ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 41.

¹⁰⁸ Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, Shqip nga Ardian Klosi (Tiranë: K&B, 2008), 141.

¹⁰⁹ Dorëzimi i kësaj shume të madhe parash, i mbajtur me procesverbal u bë në prani të dëshmitarëve Niksha de Giue, zotit Mark, zotit Nikollë Salomioni, mjeshtrit Gjon Matia, mjek kirurg, Forte Antoni de Curzola, zotërinjve Luka Martini de Florentia, Ricardo del Ben de Florentia, Filip de Arimino dhe Karlucio Alousii de Manfredonia. J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 51.

¹¹⁰ Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. XX.

¹¹¹ Franz Ritter von Miklosich, *Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii* (Viennae: Apud Guillemum Braumuller, nr.CCCLXXXV, 1858), 481-482; J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 178; Dokumenti në formë të shkurtuar edhe te: Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma*, Knjiga I, Dubrovnik i susedi njegovi. Drugi deo. Sredio Ljub. Stojanović (Beograd – Sr. Karlovići: Štampano u Srpskoj Manastirskoj Štampariji, 1934), nr. 796 (215).

¹¹² J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 181.

¹¹³ F. R. Miklosich, *Monumenta Serbica ...*, nr. CCCLXXXVI, 482.

dhënë kohë ekonomisë që të ripërtërihej,¹¹⁴ pikërisht për këto punë duhet të jenë përdorur 2 400 dukatet e nxjerra nga Ragusa.

Skënderbeu ka qenë në Raguzë herën e dytë në vitin 1461 dhe herën e tretë në vitin 1462,¹¹⁵ kohë që përkon me udhëtimin të tij në Itali, në fushatën ushtarake për t'i ardhur në ndihmë Mbretit Ferdinand të Napolit, të birit të mbretit. Për mbërritjen e tij në gusht të vitit 1461, Ragusa bëri përgatitje serioze për të pritur Skënderbeun me nderimet dhe me kushtet ashtu si ai e meritonte,¹¹⁶ dhe caktojnë edhe shtëpinë, ku Skënderbeu do të akomodohej, e cila i përkiste fisnikut Junius de Gradi.¹¹⁷ Mbi mbërritjen e tij jep të dhëna edhe kronisti raguzan Junius de Resti, i cili shkruan se Skënderbeu bëri marrëveshje me Republikën e Raguzës, që të lejohej të vendosej me familjen e vet në rast se do ta shihte të nevojshme që të largohej nga vendi i tij, për shkak të kërcënimit turk.¹¹⁸ Aty, atij iu dhanë edhe një sasi parash që kishin mbledhur për kryqëzatën.¹¹⁹ Skënderbeu kësaj here nuk ndenji gjatë në Raguzë, sepse më 25 gusht 1461 njoftohet arritja e pesë anijeve me njerëzit e Skënderbeut në Barleta, në mes të cilëve thuhet se ishte edhe ai vetë.¹²⁰ Pas fushatës italiane Skënderbeu u nis sërish për në Arbëri, dhe nga Trani ai, sipas Barletit niset drejt e në Durrës.¹²¹ Por faktet tregojnë se ai më parë ndaloi në Raguzë, më 6 shkurt 1462 dhe për shkak të motit të keq qëndroi aty disa ditë, deri në datën 11 shkurt.¹²² Për shoqërimin e tij caktohet edhe një delegacion që përbëhej nga fisnikët Bartolus de Gozze,

¹¹⁴ Virgjil Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu – Kryqtari i fundit* (Tiranë: Ombra GVG, 2011), 326.

¹¹⁵ B. Krekić, *Dubrovnik, Italy ...*, 388.

¹¹⁶ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 211; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. CLVII.

¹¹⁷ J. Radonić, *Đurađ Kastriot ...*, nr. 213; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. CLVIII.

¹¹⁸ “Chroniche ulteriori di Ragusa. Probabilmente Opera di Giovanni di Marino Gondola”, në *Monumenta spectantia Historiam, Slavorum Meridionalium*, Volumen XXV. Scriptores Volumen II. Chronica Ragusina Junii Restii (Ab origine urbis usque ad annum 1451) item Joannis Gundulae (1451-1484) (Zagabriae: Ex officina Societatis Typographicae, 1893), 359.

¹¹⁹ Po aty.

¹²⁰ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468* (Tiranë: Naim Frashëri, 1967), 123.

¹²¹ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut*, përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan J. Prifti (Tiranë: Mihal Duri, 1967), 416-417.

¹²² F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, 126.

Jacobus Marini de Gondola dhe Mikael de Volto.¹²³ Organet shtetërore raguzane marrin masa edhe për furnizimin e ushtarëve të tij që ndodheshin në Captat, duke vënë në dispozicion si ushqim peksimadhe dhe shumën e 50 hyperperëve për shpenzime të tjera.¹²⁴ Para datës së nisjes, Skënderbeu arrin që të bëjë edhe një marrëveshje për lirimin e disa shqiptarëve, të cilët ishin zënë robër në afërsi të ishullit të Lagostas dhe kishin rënë në burgjet e Raguzës.¹²⁵ Në vitin 1466, Skënderbeu po rrezikohej nga një ushtri e madhe osmane e drejtuar nga vetë Sulltan Mehmeti. Si rrjedhojë, më 18 prill 1466, Senati i Raguzës merr vendim që t'i ofrojë Skënderbeut ishullin Mljet për strehimin e tij me familje në rast rreziku.¹²⁶ Po ashtu, krahas ndihmave me armatime,¹²⁷ më 2 maj 1466 atij i ofrohet përveç ishullit Mljet edhe ishulli i Lagostës për të njëjtën gjë.¹²⁸

Në fund të vitit 1466 Skënderbeu i afrohet Raguzës, gjatë udhëtimit të tij për në Itali, ku do të vizitonte Ferdinandin e Napolit dhe do të shkonte edhe në Romë, për shkak të situatës së vështirë që ishte krijuar qoftë nga osmanët, qoftë nga venedikasit. Ai arrin në portin e Raguzës në fund të tetorit apo në fillim të nëntorit dhe më 2 nëntor 1466 Këshilli i Vogël cakton si ambasadorë të saj fisnikët *Ser Nicola Mar. de Gondola*, *Ser Aloysius de Giorgio* dhe *Ser Helias Pe. de Bona*, për të takuar Skënderbeun¹²⁹ dhe për t'u marrë vesh me të, që, nëse ishte më e udhës ai të mos zbriste në Raguzë, "*për disa arsye të mira*" të cilat në dokument nuk përmenden.¹³⁰ Nën kompetencat e rektorit të Këshillit të Vogël ishte lënë detyra e furnizimit të Skënderbeut me ushqime¹³¹ dhe thuhet gjithashtu që fusta e Skënderbeut lejohej të futej vetëm brenda zinxhirëve të portit. Ky protokoll kaq i shkurtër në lidhje me pritjen e Skënderbeut kësaj here kishte të bënte me llojin e vizitës së Skënderbeut, që ishte tranzite dhe e shkurtër, sepse destinacioni final i Skënderbeut nuk ishte Ragusa, por Italia. Skënderbeu ishte ndalur aty, me sa duket, vetëm për të

¹²³ Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. CLXIII.

¹²⁴ J. Gelcich, L. Thallóczy, *Ragusa és Magyarországa...*, nr. 17.

¹²⁵ *Po aty*.

¹²⁶ J. Radonić, *Durađ Kastriot ...*, nr. 314.

¹²⁷ Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. CCXIII.

¹²⁸ *Po aty*, nr. CCXVIII.

¹²⁹ J. Radonić, *Durađ Kastriot ...*, nr. 337.

¹³⁰ *Po aty*, nr. 314.

¹³¹ *Po aty*; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, nr. CCXVIII.

marrë të birin e tij Gjinin dhe për t'u furnizuar, dhe në të tilla raste duket se nga Republika e Raguzës përdorëshin këto protokolle, të cilat ishin të gatshme sipas llojeve të vizitave.¹³² Nëse Skënderbeu do të zbriste, qoftë edhe për pak kohë, kjo do të kërkonte një ndryshim të krejt protokollit, gjë që do t'i sillte Republikës shpenzime të kota. Këto pra ishin vetëm disa të dhëna paraprake në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Kastriotëve dhe Raguzës.

Tani në lidhje me Arianitët, sipas K. Jirečekut, i cili bazohet edhe te N. Iorga,¹³³ fisniku Gjergj Arianiti merr qytetarinë e Raguzës së bashku me të bijtë në vitin 1443, dhe përveç kësaj atij i jepet një flamur, balista dhe armë zjarri.¹³⁴ Edhe sipas Gj. Berishës, Republika i jep atij nënshtetësinë i dërgon edhe një flamur, por e refuzon kërkesën e tij për të dërguar një bombardë për nevojat e kryengritjes.¹³⁵ Por me sa duket, sipas Babinger, kjo e dhënë është një pretendim i gabuar nga Jireček.¹³⁶

Franz Babinger është i mendimit, se kjo qytetari (*cartata civilitatis*), të cilën Arianiti e pati kërkuar me anë të të dërguarit të tij më 26 gusht 1443, atij dhe të birit nuk iu dha, por nga Ragusa Arianitit iu dhanë vetëm katër bombarda dhe vendimi për to u mor më 22 nëntor 1443.¹³⁷ Ndër të tjera, me sa duket, ai kishte kërkuar edhe një flamur (*bandiera*), por edhe ajo kërkesë që refuzuar me një vendim të Këshillit të Vogël, pasi që hedhur në votim më 21 tetor 1443.¹³⁸

* * *

Këto të dhëna që paraqitëm më sipër ishin vetëm disa nga rezultatet e fundit që u arritën nga hulumtimi i dokumenteve arkivore, sidomos të Arkivit të Dubrovnikut dhe i literaturës më të mirë në lidhje me marrëdhëniet diplomatike dhe ekonomike të Raguzës me fqinjët e saj. Sigurisht dokumentet janë të shumta dhe ka edhe informacione të tjera

¹³² V. Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, 473.

¹³³ Nicolae Iorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XV^e siècle*, Publiés par N. Iorga, Professeur a l'Université Secondé Serie (Paris: Ernest Leroux, 1899), 395, ref. 5.

¹³⁴ C. Jireček, *Geschichte der Serben ...*, II/1, 183.

¹³⁵ Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, 40.

¹³⁶ Franz Babinger, *Das Ende der Arianiten*. Mit zwei Tafeln. Vorgelegt am 8. Februar 1960 (München: Bayerische Akademie der Wissenschaften, 1960), 23.

¹³⁷ HR-DADU- Acta Consilii Rogatorum, VIII [1441-1443], fl. 236 dhe fl. 256v, në *po aty*, 23.

¹³⁸ HR-DADU- Acta Consilii Maioris, VII., fl. 119v dhe 132v, në *po aty*, 23.

rreth kësaj teme që morëm në shqyrtim. Por zgjerimi i saj këtu do t'i kapërcente kufijtë e një artikulli, kështu që të dhëna të reja do të publikohen nëpër artikuj e në botimet e ardhshme.

EDMOND MALAJ

Institute of History/ Academy of Albanological Studies, Tirana
edmond.malaj@asa.edu.al

AGREEMENTS AND OTHER QUESTIONS BETWEEN
RAGUSA AND ALBANIAN NOBLES

S u m m a r y

This paper provides information about the diplomatic relations between the Republic of Ragusa and some important Albanian noble families in the middle Ages. The paper aims to introduce the most important diplomas and agreements that these families have made with the state of Ragusa. The agreements are mostly of economic nature and are mainly related to the commercial activity of the merchants of Ragusa in the Albanian territories. The families whose relationships are treated in this paper are the Castriotes, the Aranites, the Topias, the Ducaghines, the Balsha, the princes of Arbanum, etc., so the most important Albanian nobility during the Middle Ages. The paper is mainly based on archival documents of the State Archive of Dubrovnik.

